



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr.43

Prishtinë, më 4.3.2016, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-II

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI,
KULTURË, RINI DHE SPORT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, kryetar, Salih Morina, Sergjan Popoviq, Shpejtim Bulliqi dhe Mufera Shinik.

Munguan: Bekim Haxhiu, Ismajl Kurteshi, Teuta Haxhiu dhe Shukrije Bytyçi.

Pjesëmarrës të ftuar: përfaqësues të MKRS, AMPEK, dhe Besa Shahini.

Pjesëmarrës të tjerë: përfaqësues të KDI, OSBE dhe media.

Stafi mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi: Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me 24.2.2016;
3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-047 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta ;
4. Shqyrtimi i raportit me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës;
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari i Komisionit propozoi që pika e katërt e rendit të ditës të shqyrtohet para pikës së tretë. Anëtarët e Komisionit u pajtuan me këtë propozim dhe miratuan rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 24.2.2016

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 24.2.2016, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës

Nait Hasani, kryesues, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës tha se Grupi Punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës ka bërë vizita në MASHT, DKA, Shkolla publike dhe private me qëllim të marrjes së informatave për nivelin e zbatimit të këtij ligji. Gjatë këtyre vizitave Grupi Punues ka vërejtur disa mangësi të zbatimit të këtij ligji në praktikë.

Lidhur me këtë GIZ ka angazhuar ekspertin Besa Shahini për mbështetur Grupin Punues gjatë mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për Arsimin parauniversitar.

Besa Shahini, eksperte e angazhuar nga GIZ prezantoi draft raportin me të gjeturat e dala nga mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit. Ajo tha se gjatë procesit të monitorimit bashkë me Grupin Punues janë evidentuar disa mangësi që kanë të bëjnë me zbatimin e Ligjit, përkundër faktit se Ligji është i avancuar dhe përbënë një bazë të mirë ligjore për arsimin parauniversitar. Sa i përket rekomandimeve të prezantuara në draft raport, kërkoi që anëtarët e Komisionit ti shqyrtojnë dhe në mbledhjen e radhës të miratohen si rekomandime.

Nait Hasani, tha se lidhur me këtë çështje në mbledhjen e radhës të ftohet ministri i MASHT në mënyrë që MASHT të deklarohet lidhur me rekomandimet e dala nga mbikëqyrja e zbatimit të këtij Ligji.

4. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-047 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta

Nait Hasani, kryetar tha, se Projektligji Nr.05/L-047 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-065 për të drejtat e Autorit dhe të drejtat e përafërta ka pasur vërejtje të ndryshme të cilat janë adresuar në Komision nga AMPEK, si dhe me kërkesë të Komisionit është bërë një

hulumtim parlamentar. Një nga vërejtjet e AMPEK ka të bëjë me mbrojtjen e çështjes së lajmit për të cilën është debatuar edhe në dëgjimin publik të organizuar nga Komisioni.

Është thënë që mungesa e definimit të lajmit të ditës përbën një problem të madh në fushën e mediave dhe gazetarisë. Vende evropiane si Austria e kanë të definuar tashmë këtë aspekt, dhe mund të merret si praktikë referuese.

Ardita Zejnullahu- AMPEK tha, se tek ky Projektligj problemi kryesor është te Neni 12 që i referohet krijimeve pa mbrojtje, ku nuk specifikohet çka është lajm dhe çka jo. Paqartësi ka tek raportimet ditore në televizion, ku shpesh si lajm i ditës konsiderohet edhe një hulumtim disa mujor, andaj AMPEK insiston të definohet lajmi i ditës apo ngjarja aktuale. Gjatë dëgjimit publik kemi përkrahur rastin e Austrisë, dhe kufizimet kohore që egzisojnë gjatë raportimit të lajmeve. Do të ishte e nevojshme të imponohet një kufizim i tillë prej 8 apo 12 orësh në mënyrë që të mbrohen të drejtat autoriale gjatë raportimit të lajmeve. Gjithashtu ceku se problem tjetër për të drejtat e autorit janë shoqatat për administim kolektiv të cilat nuk janë funksionale.

Valon Kashtanjeva- MRKS tha se, kjo çështje është diskutar gjatë dëgjimit publik, paragrafi 1.8 tek Krijimet pa mbrojtje, terminologjia e përdorur është e njëjtë me atë të Konventës kryesore të të drejtës së autorit të Bernës. Kjo Konventë menaxhohet prej Organizatës Botërore të Pronësisë intelektuale. Në rastin kur Kosova do të anëtarsohet në organizata botërore si kjo e pronësisë Intelektuale ose në Organizatën Botërore të Tregëtisë, me marrëveshje që rregullohen aspektet ndërkombëtare të pronësisë intelektuale. Në Kosovë lajmi mbrohet, mirëpo ngjarjet e ditës dhe faktet ato nuk mbrohen si e drejtë e autorit pasi kjo do të ishte në kundërshtim me të drejtën Kushtetuese për informim të qytetarëve. Asnjë Medium në Kosovë nuk ka marrëveshje për shfrytëzimin e të drejtave të autorit. Të gjitha krijimet e krijuesve vendor përdoren nga mediat pa marrëveshje me shoqatat kolektive.

Nait Hasani, kryetar tha se do të shiqohet për mundësitë e integritit të praktikës së Austrisë në projektligjin për të drejtat e autorit dhe të drejtat e parafërta. Dhe gjatë shqyrtimit të ardhshëm të bëhen ndryshimet eventuale në projektligj.

5. Të ndryshme

Anëtarët e Komisionit diskutuan lidhur me çështjen e kthimit të librave shkollor të paraparë për nxënësit shqiptar të Luginës së Preshevës.

Anëtarët e Komisionit kërkuan që në mbledhjen e radhës të ftohet ministri i MASHT në mënyrë të njoftoi ata me gjerësisht lidhur me këtë çështje.

Mbledhja përfundoi në orën 12:20.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani